



MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

**GJETJET NGA HULUMTIMI I PUNËSIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË
KUFIZUARA NË INSTITUCIONET PUBLIKE DHE KOMPANITË PRIVATE NË
KOMUNËN E PRISHTINËS**

Gusht, 2018

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Handikos Prishtina dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

Përmbajtja

1. Hyrje	4
2. Metodologjia e Anketës.....	5
3. Grupet e synuara.....	6
4. Të gjeturat e anketës sipas grupeve të synuara	7
4.1. Prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta	Error! Bookmark not defined.
4.2. Zyrtarët arsimorë	Error! Bookmark not defined.
4.3 Zyrtarët komunalë të arsimit	Error! Bookmark not defined.
4.4. Prindërit në përgjithësi	Error! Bookmark not defined.
5. Komentet.....	Error! Bookmark not defined.
6. Rekomandimet.....	9
7. Nevojat dhe aktivitetet për adresimin e tyre	Error! Bookmark not defined.

1. Përmbledhje

Sipas raportit të OBSH-së, rreth 10% e popullatës botërore karakterizohen si persona me aftësi të kufizuara. Niveli i përqindjen ndryshon nga 5 deri 20%, varësisht prej definimit që i jep secili shtet aftësisë së kufizuar. Sipas Bankës Botërore, ky numër sillet rreth një miliardë apo 15% të gjithë popullsisë së globit. Personat me aftësi të kufizuara kanë gjasa më të mëdha të përjetojnë kushte më të këqija socio-ekonomike, si më pak edukim, shëndet më të dobët, nivele më të ulëta punësimi dhe shkallë më të lartë të varfërisë. Strategjia nacionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara thotë se gjendja e tanishme e Personave me Aftësi të Kufizuar nuk përmbush realizimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore në kushte të barabarta me të tjerët. Andaj si rrjedhojë të gjitha subjektet janë përgjegjëse për garantimin e kësaj të drejte e cila arrihet vetëm duke eliminuar çdo lloj pengese dhe barriere që krijon vështirësi në respektimin e parimit të mos-diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuara. Fatkeqësisht, ky diskriminim është evident në nivelin qendror, si dhe atë lokal të qeverisjes, përfshirë edhe komunën e Prishtinës.

Ndonëse nuk ka statistika të sakta, në Kosovë, llogaritet se jetojnë rreth 150 mijë persona me aftësi të kufizuara.¹ Ata janë grupi më e diskriminuar i shoqërisë. Këtyre personave u mohohen të drejtat më elementare, përfshirë edhe të drejtën në punësim. Bazuar në kornizën ligjore në Kosovë, së paku çdo i pesëdhjeti i punësuar duhet të jetë person me aftësi të kufizuara, ose 2% e të punësuarve në ndërmarrje. Sipas të gjeturave të hulumtimit, përveç në Trafikun Urban, ku kuota e personave me aftësi të kufizuara është 2%. Në ndërmarrjet tjera, kuota sillet rreth 0.5%.

Mohimi i së drejtës në punësim sjell me vete edhe pamundësinë e socializimit dhe integritit të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, si dhe u pamundëson atyre zhvillimin e jetës së pavarur dhe produktive. Projekti “Punësim dhe drejtësi për personat me aftësi të kufizuara” ka për qëllim të përqendrohet në rritjen e përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuara para autoriteteve lokale, përmes komitetit për personat me aftësi të kufizuara. Anëtarët e komitetit do të rrisin ndikimin e tyre te zyrtarët komunalë për të siguruar punësim më të madh për personat me aftësi të kufizuara dhe kështu të sigurojë të drejta të barabarta sociale, me theks të veçantë në të drejtën për punë.

Në kuadër të aktiviteteve të veta, projekti ka përfshirë edhe organizimin e hulumtimit për të identifikuar numrin e personave me aftësi të kufizuara që janë të punësuar në Komunën e Prishtinës. Hulumtimi ka përfshirë vetë administratën komunale, ndërmarrjet publike, si dhe kompanitë private me më shumë se 50 punëtorë, si dhe disa të tjera, që kanë më pakë, por mund të kenë të punësuar persona me aftësi të kufizuara, që operojnë në territorin e komunës së Prishtinës. Mbledhja e të dhënave u krye nga anëtarët e komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara, si dhe nga një aktivist nga gjashtë organizatat që merren me çështjen e aftësisë së kufizuar.

Pyetjet që iu parashtruan të anketuarëve kishin të bënin lidhur me numrin e përgjithshëm të të punësuarëve, pastaj me aplikimin dhe respektimin e procedurave të punësimit, lidhur me inkurajimin e personave me aftësi të kufizuara për të aplikuar. Pastaj pyetjet vijonin me atë nëse ata kishin të punësuar persona me aftësi të kufizuara në kompaninë e tyre, sa persona janë të punësuar në kompani dhe çfarë aftësie të kufizuar kanë ata. Llojet e aftësisë së kufizuara të përfshira në anketë përfshinin ato fizike, të verbër, të shurdhër, ose mendore. Ky grup i pyetjeve përfundonte me hulumtimin e përgatitjes shkollore që kanë personat me aftësi të kufizuara të punësuar nëpër kompani, ku kategorizimi bëhej nga fare e deri te përgatitje superiore e shkollimit.

¹ <http://www.evropaelire.org/a/27706536.html>

2. Metodologjia e Anketës


Në kuadër të projektit “Punësim dhe drejtësi për personat me aftësi të kufizuara”, Handikos Prishtina organizoi një hulumtim për matjen e nivelit të punësimit të personave me aftësi të kufizuara në ndërmarrjet publike dhe private që veprojnë, apo kanë zyrat kryesore në Komunën e Prishtinës. Ekipi menaxhues i projektit identifikoi çështjet kryesore të hulumtimit, si llojin e pyetjeve dhe dhe grupet e synuara, të cilëve iu drejtoheshin pyetjet. Pas identifikimit të çështjeve kryesore, menaxhmenti përpiloi pyetësin, për t’i dhënë hulumtimit drejtimin e caktuar, si dhe për t’u siguruar që të gjitha ekipet hulumtuese kthehen me informata të njëjta.

Bazuar në qëllimin e hulumtimit dhe në mënyrë që të kontribuohet në synimet dhe objektivat e projektit, hulumtimi përfshin 35 ndërmarrje publik dhe kompani private të bazuara në Prishtinë, që kanë më shumë se 50 punëtorë, si dhe disa të tjera, që kanë më pakë, por mund të kenë të punësuar persona me aftësi të kufizuara. Pyetësi, i përpiluar nga ekipi menaxhues i projektit, shqyrton tema të ndryshme të çështjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara. Këto tema përfshijnë hapjen e konkurseve për punësim, inkurajimin e personave me aftësi të kufizuara për të aplikuar, nëse kompania ka të punësuar persona me aftësi të kufizuara dhe sa, si dhe kualifikimet e tyre. Së fundi, tema përfundimtare ishte nëse i anketuari kishte njohuri mbi kornizën ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, si dhe a e zbaton kompania kriterin 50/1 për punësim të këtyre personave dhe a aplikohet neni 2 i ligjit të punës për ditë shtesë pushimi për personat me aftësi të kufizuara. Pyetësi u mundësoi hulumtuesve të kryejnë intervista gjysmë të strukturuar me 35 të anketuarit. Në vazhdim, Handikos Prishtina angazhoi pesë anëtarët e komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara, si dhe nga një përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, të cilat merren me aftësinë e kufizuar, për të zhvilluar anketën në terren.

Pas përfundimit të punës në terren, Handikos Prishtina ka angazhuar një konsulent, për të bërë analizën e të gjeturave të hulumtimit, si dhe për të përpiluar raportin e të gjeturave. Raporti përmban rezultatet e 31 intervistave, ngase katër nga 35 ndërmarrjet dhe kompanitë e përzgjedhura kanë refuzuar të japin informata mbi punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Në raport, po ashtu, do të ketë mospërputhshmëri në mes të numrit të kompanive që kanë pranuar të përgjigjen dhe numrit të përgjigjeve. Kjo është rezultat i faktit që disa nga kompanitë nuk kanë pasur informata lidhur me të gjitha pyetjet.

3. Grupi i synuar


Grupi i përfshirë në hulumtim ishin ndërmarrjet publike dhe kompanitë private të bazuara në prishtinë, të cilat kanë më shumë se 50 punëtorë, si dhe disa të tjera, që kanë më pakë, por mund të kenë të punësuar persona me aftësi të kufizuara. Nga ndërmarrjet e synuara, 20 ishin publike, 11 kompani private, ndërsa katër kanë refuzuar të marrin pjesë në hulumtim. Nga këto, një është ndërmarrje publike – RTK dhe tri janë kompani private – RTV 21, KTV dhe IPKO. Nga 35 ndërmarrjet e përfshira në hulumtim, shtatë kanë më pak se 50 punëtorë. Kompania me më së paku punëtorë, gjegjësisht 10 syresh në përgjithësi, ka edhe një punëtorë me aftësi të kufizuara. Edhe një kompani tjetër me 40 të punëtorë gjithsejt, punëson dy persona me aftësi të kufizuara. Pra, vetëm dy nga shtatë kompanitë e intervistuar, që kanë më pak se 50 punëtorë, kanë të punësuar persona me aftësi të kufizuara.



Grafiku 1


4. Të gjeturat e hulumtimit

Në pyetjen e parë se a shpallet konkursi për çdo vend pune, 27 ndërmarrje janë përgjigjur me PO, ndërsa 1 është përgjigjur me JO. Në këtë rast, nuk janë përgjigjur shtatë ndërmarrje të adresuara me aktivitetet e hulumtimit, përfshirë edhe ato katër që kanë refuzuar të marrin pjesë në hulumtim. Përgjigjet e dhëna në këtë pyetje tregojnë se shumica e ndërmarrjeve dhe kompanitve kosovare respektojnë procedurat e punësimit, sipas ligjeve aplikative në vend.




Grafiku 2

Në pyetjen nëse inkurajohen personat me aftësi të kufizuara të aplikojnë për vendet e shpallura të punës, 19 nga të ata që janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen paraprake, janë përgjigjur me PO, ndërsa 8 janë përgjigjur me JO. Nga kjo përgjigje mund të konstatojmë se shumica e ndërmarrjeve i inkurajojnë personat me aftësi të kufizuara të aplikojnë për pozitat e punës. Sidoqoftë, duke pasur parasysh se vetëm 26 ndërmarrje janë përgjigjur në këtë pyetje, del se pak më shumë se 30% e kompanive nuk i kushtojnë rëndësi punësimit të këtij grupi të marginalizuar të qytetarëve.



Grafiku 3

Pyetja në vazhdim kishte të bënte me atë nëse kompania kishte të punësuar persona me aftësi të kufizuara. Në këtë pyetje, 10 prej ndërmarrjeve të hulumtuara janë përgjigjur me PO, ndërsa 5 prej tyre me JO. Shumica e kompanive të përfshira në hulumtim nuk kanë pranuar të japin përgjigje në këtë pyetje, prandaj edhe mund të sygjerojmë që ato nuk kanë të punësuar ndonjë person me aftësi të kufizuara. Ndërsa në pyetjen se sa persona me aftësi të kufizuara janë të punësuar në ndërmarrje, natyrisht përgjigjet variojnë nga NJË deri në 95. Nga 31 kompanitë e përfshira në hulumtim, dhe që kanë pranuar të përgjigjen në pyetje, prin Telekom i Kosovës me 95 persona me aftësi të kufizuara të punësuar.




Grafiku 4

Pyetja vijuese ka parashtruar çështjen e njohurive të kompanive kosovare me ligjin, ku të intervistuarit janë pyetur nëse kanë njohur mbi ligjin për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Në këtë pyetje 19 ndërmarrje janë përgjigjur me PO, ndërsa 5 me JO. Kjo nënkupton vetëdije të ulët të ndërmarrjeve kosovare lidhur me kornizën ligjore në Kosovë, që kërkon punësim të personave me aftësi të kufizuara.

Lidhur me zbatimin e kriterit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, ku sipas ligjit çdo i pesëdhjeti punëtor duhet të jetë person me aftësi të kufizuara, 14 ndërmarrje janë përgjigjur me PO, ndërsa 12 me JO. Duke pasur parasysh se vetëm 10 kompani janë përgjigjur se kanë persona me aftësi të kufizuara të punësuar, kemi mospërputhshmëri të deklaratave, ku duket se të intervistuarit janë përgjigjur bazuar në atë se si do të duhej të ishte gjendja, kur respektohet korniza ligjore për punësim, dhe jo se si është gjendja faktike në ndërmarrjet e tyre.

Kjo pyetje është pasuar edhe me pyetjen tjetër sqaruese nëse ndërmarrja respekton ligjin ku kërkohen ditë shtesë pushimi për personat me aftësi të kufizuara. Në këtë pyetje janë përgjigjur me Po 8 ndërmarrje dhe JO po ashtu 8, ndërsa tjerat nuk kanë dhënë kurrfarë përgjigje, që mund të supozohet se ky nen i ligjit për punësim nuk implementohet sa duhet në shumicën e kompanive, të cilat kanë të punësuar personave me aftësi të kufizuara.



Grafiku 5

5. Rekomandimet

- Zyrtarët në nivel qendror dhe në atë lokal të jenë fokusi primar i avokimit për zbatim të kornizës ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.
- Ndërmarrjet në përgjithësi, si punëdhënësit primarë potencialë për personat me aftësi të kufizuara të jenë fokusi i aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për punësim.
- Të ngritet vetëdija e përfaqësuesve të ndërmarrjeve publike dhe kompanive private lidhur me ligjin dhe kërkesat e tij për punësim të personave me aftësi të kufizuara.
- Të ngritet vetëdija e ndërmarrjeve dhe kompanive që kanë të punësuar persona me aftësi të kufizuara mbi të drejtën e tyre për ditë shtesë të pushimit.

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).